



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivery	03.08.2022	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANJIK	4507/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.572/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.572/2022 të datës 27.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi undër organit të punësimit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.572/2022 e datës 27.06.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi Kordinator i Zyres Regjionale në Mitrovicë, në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, me datën 27.06.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1414/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me harmonizimin e koeficientëve për njëmbëdhjetë (11) inspektorët në AVUK për rajonin e Mitrovicës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 05.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 07.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 3727/2022 të datës 27.06.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 18.07.2022 nga

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë; Vendimin nr.6639 te datës 05.09.2018 lidhur me transferimin e ankuesit së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin 7196 të datës 20.10.2021; Vendimin 8880 të datës 09.12.2021; Vendimin 7197 të datës 20.10.2021; Vendimin 7195 të datës 20.10.2021; Vendimin 7220 të datës 20.10.2021; Vendimin 8882 të datës 09.12.2021; Vendimin 6787 të datës 04.10.2021; Vendimin 8881 të datës 09.12.2021; Vendimin 7199 të datës 20.10.2021; Vendimin 7198 të datës 20.10.2021; Vendimin 7200 të datës 20.10.2021; Vendimin 1055 të datës 04.02.2022 se bashku me përshkrimin e detyrave të punës për pozitat inspektor sanitar, veterinar dhe fotosanitar; Përgjigjet në kërkesë përmes e-mailit zyrtar të datës 03.03.2022 lidhur me harmonizimin e koeficienteve; Kërkesën për harmonizim të koeficientit te datës 02.03.2022 përmes e-mailit zyrtar; Rregulloren Nr.01/2011 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë të datës 27.03.2012; Formularin e shpenzimit dhe planifikimin e buxhetit te AVUK për vitin 2022; Shkresën zyrtare me numër 1444 të datës 28.03.2014 lidhur me procedimin e shtesës; Përgjigjen në kërkesë të datës 09.03.2022, 07.03.2022, 01.04.2022 përmes e-mailit zyrtar lidhur me harmonizimin e koeficientit; Kërkesën për harmonizim të koeficientit të datës 02.03.2022; E-mailat zyrtar të datës 27.04.2022; 07.03.2022, 02.03.2022, 15.06.2022, 13.06.2022, 14.06.2022, 10.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...", andaj ndërlidhur me këtë Kolegji vlerëson se mbi bazën e arsyeve të kundërshtuara me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.572/2022 e datës 27.06.2022, e parashtruar nga ankuesi është e palejuar.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.572/2022, datë 03/08/2022.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

